



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsioni, duke vepruar në rastin e formuar pas kërkesës së paraqitur nga parashtruesi i panjohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK), në seancën e 72-të të mbajtur më 29.07.2022 ka miratuar si në vijim.

VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 12-4412/1 nga data 03.05.2022 kundër -----, **HIDHET POSHTË.**

KSHPK përcaktoi se sipas Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit nuk ka elemente për veprim kompetent.

Denoncimin të dorëzohet për veprim kompetent në Prokurorinë Publike Themelore për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Lënda me numër 12-4412/1 të datës 03.05.2022 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarjes.

Arsyetim

Nga një parashtrues i panjohur, më datë 03.05.2022, është dorëzuar denoncim kundër ----- drejtorë në ----- dhe është formuar lënda me numër 12-4412/1 nga 03.05.2022.

Në denoncim nga parashtruesi kërkohet të kontrollojë të gjitha librat e biznesit dhe dosjet e ----- ku mbahen të dhënat e paraqitura nën bazën e "anonimitetit", për të përcaktuar se çfarë është bërë pas këtyre njoftimeve nga ana e tyre, nëse prokurori është i informuar për rezultatit e këtyre procedurave dhe se si është arkivuar lënda me vetëm një shënim zyrtar. Për më tepër, parashtruesi kërkon të kontrollohen të gjitha lëndët ----- konstatohet se është një prokuror i caktuar dhe se me urdhër të prokurorit është lënda e mbyllur, nëse ekziston

ndonjëherë një njoftim i tillë në librat e biznesit të prokurorisë dhe nëse ekziston ndonjëherë një informacion i tillë që ----- u drejtua dhe kërkoi opinion nga prokuroria për lëndët konkrete, dhe një kërkesë e tillë drejtohet për të gjitha lëndët e mandatit të parë përfundimtar dhe tani si kryetar i detyrës në postin e drejtorit të personit të përmendur.

Në vazhdim të denoncimit kërkohet të përcaktohet nëse dhe kundër personit juridik ekziston një deklaratë anonime në kohën e menaxhimit të drejtorit të përmendur me institucionin, çfarë është ndërmarrë dhe nëse drejtori i personit juridik ishte i mbuluar me atë deklaratë dhe pse atëherë drejtori nuk ka vepruar sipas detyrës zyrtare si detyrimi i tij ligjor. Gjithashtu kërkohet të përcaktohet edhe për personin zyrtarë----- çfarë është ndërmarrë, çfarë është konstatuar, nëse është konsultuar prokurori dhe si është mbyllur lënda.

Duke pasur parasysh pretendimet e denoncimit, si dhe informacionin e publikuar publikisht se prokuroria tashmë vepron pas njoftimeve me akuzë të ngjashme kundër të njëjtës person, KSHPK-ja vlerësoi se denoncimi të dorëzohet në procedimin kompetent në Prokurorinë e Përgjithshme Publike për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Në bazë të lartpërmendurës, KSHPK-ja vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

Përgatiti: B.K.SH

KOMISIONI SHTETËRORE
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT
Nënkryetar
Nuri Bajrami